

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit

Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI) është një bazë shtetërore të dhënash e krijuar me VKM nr. 145, datë 13.03.2018, në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit". "Regjistri" është i integruar në portalin "pyetshtetin.al", që është një platformë proaktive komunikimi mes qytetarëve dhe Autoriteteve Publike në funksion të transparencës dhe llogaridhënies.

Sistemi elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit i ofron mundësinë çdo qytetari apo/dhe çdo grup interesi të mund të dërgojnë në mënyrë të thjeshtë elektronike kërkesat pranë autoriteteve publike si edhe të ankesave në rast refuzimi të informacionit të kërkuar, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Një nga veçoritë e REKPDI është se i gjithë procesi i trajtimit të kërkesave/përgjigjeve, por edhe ankesave pranë Zyrës së Komisionerit, realizohet brenda sistemit, duke mundësuar gjurmueshmërinë elektronike.

Ky sistem synon të lehtësojë aksesin e qytetarëve si dhe çdo grupi interesi për informacion publik, si edhe të rrisë cilësinë e shërbimit duke ofruar mundësinë për të marrë informacionin publik në një kohë sa më të shkurtër.

Nëpërmjet këtij sistemi qytetarët mund të gjurmojnë statusin e kërkesës duke përdorur kanalet informatike. Gjithashtu qytetarët informohen me anë të email në momentin që kërkesa është e shqyrtuar.

Për të dërguar kërkesën e parë nëpërmjet sistemit elektronik, hyni në faqen www.pyetshtetin.al dhe klikoni tek ikona "Kërko Informacion".

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim Nr. 44 - Ujësjiellës
Kanalizime Tiranë Sh.A

Vendim Nr. 45 - Bashkia Elbasan

Rekomandim nr.45 - Bashkia
Himarë

Rekomandim nr.46 - Bashkia Korçë

Rekomandim nr.47 - Bashkia Dibër

Rekomandim nr.48 - Bashkia Krujë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit shtator, ka dhënë dy vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI) dhe 4 Rekomandime.

Me anë të Vendimit nr. 44, datë 07.09.2021 KDIMDP ka pranuar ankesën për refuzim dhënie informacioni ndaj Ujësllës Kanalizime Tiranë Sh.A (Autoriteti Publik) ku kërkohej informacion mbi:

- *Emrat dhe pozicionin përkatës të të gjithë punonjësve aktualë pranë Ujësllës Kanalizime Tiranë.*

Në ndjekje të procedurave administrative, KDIMDP kërkoi nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Autoriteti Publik, në përgjigjen e tij argumentoi se: *Autoriteti Publik është shoqëri aksionere. Në këtë kontekst, asnjë prej të punësuarëve në këtë shoqëri nuk kryen funksione shtetërore. Kërkesa çënon parimet bazë të detyrueshme për zbatim nga çdo institucion apo person juridik, referuar ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Informacioni i kërkuar nuk ka lidhje me interesin publik, në zbatim të të cilit është ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".*

Gjithashtu, sipas "Regullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" të Autoritetit Publik përcaktohet se: "Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale të personelit të Autoritetit Publik është për efekt të krijimit të marrëdhënies së punës e përmbushjes së detyrimeve për administrimin e dosjeve personale të punonjësit" dhe në funksion të saj citohet se: "Të dhënat personale të përpunuara për denoncuesit e subjekteve të kontrolluara, personelin e Autoritetit Publik dhe vizitorë, gëzojnë mbrojtjen sipas ligjit dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera të ndryshme nga ai i grumbullimit të tyre".

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, KDIMDP vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk janë në përputhje me parashikimet e LDI dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Bazuar në nenin 1 të ligjit të LDI, përcaktohet qartë se, ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.

Referuar pikës 1 të nenit 2 të LDI, "Autoritet publik": a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Për sa më sipër, nga verifikimet në QKB, rezulton se Autoriteti Publik është shoqëri aksionere, me aksione 100% publike, që ushtron funksione publike, me objekt veprimtarie përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatoreve. Për rrjedhojë, ky institucion është Autoritet Publik në kuptim të LDI dhe detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesave, KDIMDP vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie të informacionit të kërkuar në të gjitha pikat e kërkesës.

Në vendimarrjen e tij, Zyra e Komisionerit informon palët për të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

28 Shtator – Dita e të Drejtës për Informim, Transparenca proaktive e Autoriteteve Publike të sektorit shëndetësor

Transparenca proaktive e Autoriteteve Publike në sektorin shëndetësor është tematika e aktivitetit të organizuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me rastin e 28 Shtatorit – Ditës së të Drejtës për Informim.

Në takim ishin të ftuar të veçantë znj. Eugena Tomini, zv. Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Albana Fico Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Shëndetit Publik, znj. Mirela Cami Drejtor i Përgjithshëm i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe z. Skënder Brataj, Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore dhe përfaqësues e koordinatore të të drejtës për informim nga institucione të këtij sistemi nga i gjithë vendi.

Komisioneri Besnik Dervishi, në fjalën e tij theksoi veprimtaria e këtyre Autoriteteve Publike ka qenë në vëmendjen e Zyrës gjatë situatës së pandemisë COVID-19. “Në këtë aktivitet kemi ftuar institucionet që kanë përballuar peshën kryesore gjatë kësaj periudhë të pazakontë, me të cilat kemi patur një bashkëpunim të ngushtë, si dhe i kemi mbështetur për të siguruar transparencën e veprimtarisë së tyre dhe zbatimin e të drejtës për informim”.

Në këtë takim u diskutua zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit gjatë kësaj periudhe nga Autoritetet Publike në sektorin e shëndetësisë. Gjithashtu u vu theksi tek programi i transparencës si instrumenti më i rëndësishëm për transmetimin e informacionit në publik apo me grupet e interesit; trajtimi i kërkesave për informacion në afat dhe në përmbajtje, si dhe fuqizimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit.



Lista e autoriteteve publike që kanë instaluar Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit

Sistemi elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit është instaluar dhe po funksionon në 71 autoritete publike. Çdo qytetar mund të aksesojë listën e autoriteteve publike dhe të zgjedh atë institucion drejt së cilët do të dërgohet kërkesa për informacion. Më poshtë gjeni listën e autoriteteve publike të cilët gjenden aktualisht në regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve. Kjo listë do të pasurohet edhe me autoritete të tjera në vijim.

KRYEMINISTRIA

MINISTRIA ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRIA E BRENDSHME

MINISTRIA E BUJQËSISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGIJISË

MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

BANKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

BASHKIA DEVOLL

BASHKIA DIBËR

BASHKIA DURRËS

BASHKIA ELBASAN

BASHKIA FIER

BASHKIA GJIROKASTËR

BASHKIA GRAMSH

BASHKIA HIMARË

BASHKIA KAMËZ

BASHKIA KLOS

BASHKIA KOLONJË

BASHKIA KORÇË

BASHKIA KUKËS

BASHKIA LEZHË

BASHKIA MALIQ

BASHKIA MAT

BASHKIA MEMALIAJ

BASHKIA PATOS

BASHKIA POLIÇAN

BASHKIA SELENICË

BASHKIA SKRAPAR

BASHKIA SHIJAK

BASHKIA SHKODËR

BASHKIA TIRANË

BASHKIA VLORË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE-AKBN

AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE

INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE

AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE

AUTORITETI I KONKURENCËS

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK

DHE SIGURINË KIBERNETIKE

AUTORITETI PËR INFORMIM MBI DOKUMENTET E ISH-

SIGURIMIT TË SHTETIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT

PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARTIZIMI

ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISË

ENTI RREGULLATOR I UJIT

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT

TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË

INTERESAVE

INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT

INSPEKTORATI QENDROR

INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

INSTITUTI I STATISTIKAVE

INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E

KOMUNIZMIT

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE

MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

POLICIA E SHTETIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR